<p>Viti 2024</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mirëmbajtja e gjithë sipërfaqes përfshirë dhe sipërfaqen e parcelave të reja të cilat do të plotësojnë kërkesat për shërbime funerale. • Administrim më i mirë i territorit nëpërmjet investimit për rrethimin e pjesëve të dëmtuara dhe ndricimit të territorit në bashkëpunim me operatorin sipërmarrës. • Ofrimi i shërbimit me punonjës të shërbimeve publike në njësitë administrative • Ofrimi i shërbimit të varrimit për personat që nuk kanëpërkujdesje nga të afërm, ku përshihen arkivoli, veshmbathja dhe shpenzimet për shërbimin e varrimit. • Shtimi me 10 000 m² i sipërfaqes së investuar në mirëmbajtje. <p>Viti 2025 – 2026</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mirëmbajtja e gjithë sipërfaqes përfshirë dhe sipërfaqen e parcelave të reja të ndërtuara me investim në vitin 2023. • Përmirësim i shërbimit të varrezave publike në Bashkinë Shkodër. • Përmirësim i performancës së ofrimit të shërbimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit dhe rregullores. • Realizimi i procedurave për planifikim territori për ndërtimin e varreza publike për t'i paraprirë nevojave të komunitetit pas shfrytëzimit të sipërfaqes ekzistuese. • Realizimi i projektit dhe investimit për ndërtim të varrezave publike. • Ofrimi i shërbimit të varrimit për personat që nuk kanë të afërm, ku përshihen arkivoli, veshmbathja dhe shpenzimet për shërbimin 		

e varrimit.

b) Rezultatet që prisni

Viti 2024-2026

- Ofrim i shërbimit me standarte për mirëmbajtjen e varrezave publike.
- Garantimin e nevojave për vijimësinë e shërbimit dhe administrimit më të mirë të territorit.
- Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpërmjet një sistemi më efikas të monitorimit.
- Zgjerim territori për varreza në NJ.A
- Realizimi i studimit për sigurimin e një territori për ndërtim të varrezave publike për t'i paraprirë nevojave të komunitetit pas shfrytëzimit të sipërfaqes ekzistuese
- Realizimi i projektit dhe planifikimi i investimit për ndërtim të varrezave publike.

c) Aktorët e mundshëm

1. Drejtorja e Shërbimeve dhe Monitorimit
2. Institucioni që ndjek shpenzimet: NSHPP

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkoder

Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	Kapital e
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve Qytet dhe varrezat e dëshmorëve (01.01.2024-15.05.2024)	5,900			5,900		
A.2	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve Qytet dhe varrezat e dëshmorëve (16.05.2024-31.12.2024)	9,932			9,932		
A.4	Shërbime varrimi për raste të veçanta	800			800		
	Shuma	16,632			16,632		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	Kapital e
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe varrezat e dëshmorëve.	15,900			15,900		
A.2	Shërbime varrimi për raste të veçanta	800			800		
A.3	Ndërtim parcela të reja	5,000					5,000
	Shuma	21,700			16,700		5,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	Kapital e
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe të dëshmorëve	15,900			15,900		
A.2	Shërbime varrimi për raste të veçanta	800			800		
A.3	Ndërtim parcela të reja	5,000					5,000
	Shuma	21,700			16,700		5,000
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2024, 2025, 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Shërbimeve dhe Monitorimit Institucioni likuidues: Ndermarrja e shërbimeve dhe punëve publike					

Nr.4	P06260. Q2. O1.A1 Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore
------	--	--

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

I. Situata

A. Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbëra.

Shërbimi I mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta gjatë vitit 2023 është realizuar me sipërmarrje private bazuar në kontratën e shërbimit

Gjatë këtij viti krahas shërbimeve të parashikuara një vëmendje e vecante I është kushtuar zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimit të sipërfaqeve ekzistuese . Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 121 791 m² sipërfaqe të gjelbër, ku përfshihen 74 lulishte ndër të cilat 96 300 m² në qytet dhe 25 491 m² lulishte në Velipojë. Këto lulishte sipas rëndësisë dhe sipërfaqeve përkatëse janë specifikuar sipas kategorive të sipërfaqeve të gjelbërta, tipi "A", "B", "C".

Sipërfaqe të gjelbra Tipi A (Intensive) me sipërfaqe 56 742 m² -përfshihen lulishte dhe parqe Urbane me sipërfaqe më të madhe se 5 000 m², e kushtëzuar nga frekuentimi I lartë social.

Sipërfaqe të gjelbra Tipi B (të rëndësishme) me sipërfaqe 41 211 m² – përfshihen zona të gjelbra të lagjeve, rrethrotullime, dhe parqe lojtrash.

Sipërfaqe të gjelbra Tipi C (mirëmbajtje me frekuencë të reduktuar) me sipërfaqe 23 838 m² – përfshijnë zona të gjelbra me shërbim, me frekuenca të reduktuara sipas grafikut e mirëmbajtjes.

Janë kryer sipas grafikëve të përcaktuar në funksion të tipologjive dhe elementet atraktiv të këtyre sipërfaqeve në zërat e: mirëmbajtjes së sipërfaqes së barit, drurëve dekorativë, bordurave të gjelbra, shkurreve, sipërfaqeve ujore, mirëmbajtjen dhe riparimin e stolave, pastrim i rrugëve të brendshme etj.

Është realizuar gjatë gjithë vitit mirëmbajtja e rrugës së Shirokës duke barë pastrimin e rrugës dhe trotuarëve nga bimësitë e këqia, pastrimi I bregut të liqenit si dhe pjesës ujore në afërsi të bregut

Është realizuar gjatë gjithë vitit mirëmbajtja e rrugës së Kalasë duke barë pastrimin e rrugës dhe trotuarëve nga bimësitë e këqia.

Gjatë këtij viti janë realizuar shërbime të mirëmbajtjes në sipërfaqet e rikonstruara gjatë vitit të fundit .

Jane vendosur gjithashtu 70 copë stola të rinj dekorativ në lulishte dhe shëtitore.

Shërbimi I gjelbrimit gjatë vitit 2023 është realizuar sipas zërave të preventivit më poshtë:

- Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Tipi A – me sipërfaqe 56 742 m²
- Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Tipi B – me sipërfaqe 41 211 m²
- Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Tipi C – me sipërfaqe 23 838 m²
- Mirëmbajtje gjelbrim Rrugor Tipi 1 – 2 986 copë
- Mirëmbajtje gjelbrim Rrugor Tipi 2 – 1 824 copë
- Mirëmbajtje gjelbrim Rrugor Tipi 3 – 1 980 copë
- Mirëmbajtje stola dekorative – 464 copë
- Mirëmbajtje shkurre dekorative (Rr. Mehmet P. Plaku) – 800 copë
- Mbjellje drure dekorativë (lulishte dhe gjelbrim rrugor) – 200 copë
- Mbjellje shkurre dekorative – 120 copë
- Prodhim fidanë lule sezonale në fidanishte – 1070 m²
- Mbjellje bordurë e gjelbër – 150 ml
- Shërbimi I mirëmbajtjes së Rrugës së Kalasë (shkulje e rrënjëve te bimëve të vogla) – 9 440 m²
- Shërbimi I mirëmbajtjes së rrugës së Shirokës dhe bregut të liqenit (prerje bimë të vogla) – 68 600 m²
- Mirëmbajtje sipërfaqe ujore qytet – 650 m²
- Mirëmbajtje sipërfaqe ujore Velipojë – 491 m²

Një vëmendje e shtuar ka patur këtë vit në Plazhin Velipojë duke krijuar një ambjent më tërheqës dhe duke kjuar një mjedis më tërheqës për pushuesit e shumtë vendas dhe të huaj.

Është realizuar shërbimi mirëmbajtje në sipërfaqen e gjelbër (lulishte) në qendrën e plazhit Velipojë. Shërbimi është realizuar në një sipërfaqe prej 25 000 m² lulishte dhe 491 m² sipërfaqe ujore (shatërvanet). Brenda kësaj sipërfaqeje ka dhe elementë të tjerë si, stola dekorativ 90 copë dhe drurë dekorativ 300 copë, gjelbërim rrugor 76 rrënjë.

Njëkohësisht realizohet dhe mirëmbajtja e gjelbërimit rrugor në qytet dhe Njësitë Administrative, të cilave i shërbehet sipas grafikëve të përcaktuar.

Është realizuar vendosja e 10 copë stolave të rinj dekorativ në lulishten e plazhit Velipojë

Është realizuar vendosja e 156 koshave të vegjël për hedhjen e mbetjeve të financuar nga FSHZH në lulishte dhe shetitore.

Është realizuar mirëmbajtja e gjelbërimit rrugor në qytet dhe Njësitë Administrative, të cilave i shërbehet sipas grafikëve të përcaktuar.

Gjatë vitit 2023 janë mbjellur 300 copë drurë dekorativë në rrugët e rikonstruara me investime të Bashkisë Shkodër që I shtohet gjelbërimit rrugor ekzistues dhe numëri I përgjithshëm arrin 7300 rrënjë pemë.

- Dëmtimi i sipërfaqeve të lulishteve.

Dëmtimi i stolave nga amortizimi, por edhe nga veprimet e qëllimshme nga persona të papërgjegjshëm, kryesisht në zonën Pedonale-Molo.

Situata e vlerësuar:

- Dëmtimi i sipërfaqeve të lulishteve.

Dëmtimi i stolave nga amortizimi, por edhe nga veprimet e qëllimshme nga persona të papërgjegjshëm, kryesisht në zonën Pedonale-Molo.

- Ndotja e shatërvaneve dhe dëmtimet, shpesh nga papërgjegjshmeria e qytetarëve që hedhin mbeturina në to dhe prishin

aksesorët e shatërvanit.

- Nevoja për shtimin e frekuencave për mirëmbajtje të bregut të liqenit nga papastërtitë dhe bimësitë e keqija.
- Planifikimi i ndërhyrjes për riorganizimin e hapësirave të gjelbërta, duke u mbështetur në kulturen dhe traditën e qytetit në kultivimin e bimëve tradicionale.
- Nevoja për shtim të gjelbërimit rrugor në Njësitë Administrative.

II. Synimi i projektit

-Realizimi të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra, për të gjithë Bashkinë, me objektivin për të rritur sipërfaqe të gjelbërta në funksion dhe në përputhje me pritshmëritë e të qytetarëve.

Përmirësimi i gjelbërimit rrugor, nëpërmjet ndërhyrjeve sipas vlerësimit të specialistëve sipas tipologjisë së drurëve

- Riorganizimi i sipërfaqeve të gjelbra në kuadër të përmirësimit të peisazhit urban dhe historik, si dhe për të qënë funksional për të gjithë komunitetin si dhe duke prezantuar, sipas traditës dhe kulturës së qytetit, me bimësi si: lagerstroma, trëndafila, lule vjollë, kadife, ciklamin, salvia etj.

-Përmirësim të mëtejshëm të imazhit në lulishten e plazhit Velipojë në funksion të pushuesve vendas dhe të huaj.

- Krijimi i sipërfaqeve të reja të gjelbra, të përfshira në projektet e investimeve për rikualifikim të zonave urbane.

- Zgjerim i gjelbërimit rrugor në Nj.A, sipas prioriteteve.

-Përmirësim i cilësisë së mirëmbajtjes dhe të frekuencave për pika të rëndësishme turistike të qytetit, si rruga e Kalasë Rozafat, Bregu i liqenit dhe tek Ura e Mesit, sipas eventeve të ndyshme në këto dy zona.

6- Pastrim të bregut të liqenit, pjesa ujore, nga papastërtitë si: alga, mbeturina plastike, druri etj.

7 - Mirëmbajtje e bankinave të rrugëve dhe trotuareve duke i pastruar nga bimësia e gjelbër (bari).

Planifikimi për shërbimin në vitin 2024:

	(lekë)
Mirëmbajtje e Sipërfaqe të gjelbra	41,735,000
Investime	0
TOTAL	41,735,000

Mbulimi i kostove të shërbimit të gjelbërimit për vitin 2024 përllogaritet si më poshtë(RAKORDIMI ME TAKSAT)

(lekë)

Familjet	Nr. I familjeve përfituese tëshërbimit	Nr. i mesatarizuar i familjeve që paguajnë (jane hequr familjet me lehtësi fiskale)	Tarifa e gjelbrimit	Të ardhurat nga tarifat e gjelbrimit
Shkodër	35,425	19,910	600	11,950,000
TOTAL				11,950,000

Të ardhura nga biznesi **14,200,000**

Të ardhurat nga institucionet **160,000**

TOTALI I TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA 26,310,000



lii. Aktivitetet kryesore të projektit

Viti 2024

Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sipërfaqeve të gjelbra ekzistuese me të gjitha elementët sipas kontratës me operatorin sipërmarrës si dhe sipërfaqet e reja të nga investimet e Bashkisë Shkodër.

Rikualifikimi i lulishteve ekzistuese duke përmirësuar kushtet sipas pritshmërisë së qytetrëve

Do të kryhet mirëmbajtja e gjelbrimit rrugor në rrugët ekzistues si dhe mirëmbajtja e atyre të mbjella gjatë vitit 2023.

Rikualifikim të blloqeve të banimit si pjesë e investimeve nëpërmjet rikonstruksioneve të reja.

Vazhdim i përmirësimit të dhe zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra në plazhin Velipojë dhe zona të tjera turistike.

Përmirësimi i sistemit të monitorimit të shërbimit në kuadër të plotësimit të detyrimeve kontraktuale, apo detyrave të përcaktuara

Viti 2025– 2026

Përmirësim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për të gjithë Bashkinë.

Rritje e investimeve për gjelbërim rrugor në Nj.A.

Përmirësimi i performancës së ofrimit të shërbimit të gjelbërimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve

b) Rezultatet që prisni**Viti 2024-2026**

Do të hartohet një plan i saktë veprimi për një periudhë afatmesme, i cili do të analizojë nevojat, kostot, dhe do të përcaktojë në kohë afatmesme synimet dhe indikatorët e matshëm për performancën e ofrimit të shërbimit.

Shtim i sipërfaqeve të gjelbërimit dhe gjelbërimit rrugor.

Ofrim i shërbimit të standartizuar për hapësirat e gjelbërta ekzisutese.

Rritje në përqindje dhe dendësi e sipërfaqeve të gjelbërta, funksionale në shërbim të qytetarëve të Shkodrës.

Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpërmjet një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit.

c) Aktorët e mundshëm

- Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit
- Institucioni që ndjek shpenzimet: NSHPP

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkoder

Shpenzimet për çdo aktivitet 2024

Totali
(mije lekë)

Nga kjo:

Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
------	----------	-----------	-------------	----------

A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra (01.01.2024-07.11.2024)	34,219		34,219		
A.2	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra (08.11.2024-31.12.2024)	7,516		7,516		
	Shuma	41,735		41,735		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2025

Totali
(mije lekë)

Nga kjo:

Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
------	----------	-----------	-------------	----------

A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra	41,735		41,735		
	Shuma	41,735		41,735		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026A

Totali
(mije lekë)

Nga kjo:

Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
------	----------	-----------	-------------	----------

A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra	41,735		41,735		
	Shuma	41,735		41,735		

f) Periudha e zbatimit

Gjatë viteve 2024, 2025, 2026

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit

Institucioni likujdues: Ndermarrja e shërbimeve dhe puneve publike

Nr.5	P06260.Q2.O1.A2 Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve ujore	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260:Shërbimet Publike Vendore
------	---	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

I. Situata

B. Shërbimi i C

Shërbimi I mirëmbajtjes së sipërfaqeve të ujore gjatë vitit 2023 është realizuar si pjesë e kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberta.

Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 650 m² në qytet ku përfshihen shatervani lulishte Parrucë dhe shatervani sheshi "Demokracia", si dhe mirëmbajtje sipërfaqe ujore Velipojë – 491 m²

Janë kryer sipas grafikëve të përcaktuar shërbimet për mirëmbajtjen e sipërfaqes ujore si pastrami me detergjentë, dezinfektimi

Mbajtja në gatishmëri e sistemit të pompave me mirëmbajtja e tyre.

Shërbimi I mirëmbajtjes së sipërfaqeve ujore në Plazhin Velipojë realizohet gjatë periudhës Maj-Tetor për të krijuar një mjedis më tërheqës për pushuesit e shumë vendas dhe të huaj gjatë sezonit turistik.

Situata e vlerësuar:

- Dëmtimi i shatervanëve nga persona të papërgjegjshëm në veshje dhe sprucatorët e hedhjes së ujit.
- Ndotja e shatërvaneve dhe dëmtimet, shpesh nga papërgjegjshmeria e qytetarëve që hedhin mbeturina në to dhe prishin aksesorët e shatërvanit.

II. Synimi i projektit

- Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore me qëllim ërmirësim të mëtejshëm të imazhit në lulishten e plazhit Velipojë dhe shatervanëve në qytet

Planifikimi për shërbimin në vitin 2024:

	(lekë)
Mirëmbajtje e Sipërfaqe ujore	765,000
Investime	0
TOTAL	

lii. Aktivitetet kryesore të projektit

Viti 2024

- Shërbimi I mirëmbajtjes së sipërfaqeve të ujore në qytet dhe në lulishten e Plazhit Velipojë si pjesë e kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberta.

-Mbajtja në gatishmëri e sistemit të pompave dhe mirëmbajtja e tyre

Viti 2025– 2026

- Shërbimi I mirëmbajtjes së sipërfaqeve të ujore në qytet dhe në lulishten e Plazhit Velipojë si pjesë e kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberta.

-Mbajtja në gatishmëri e sistemit të pompave dhe mirëmbajtja e tyre

b) Rezultatet që prisni

Viti 2024-2026

-Ofrim i shërbimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të ujore në qytet dhe në lulishten e Plazhit Velipojë si pjesë e kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberta.

-Përmirësim I frekuencave të shërbimit me grafike të përcaktuar

-Mbajtja në gatishmëri e sistemit të pompave dhe mirëmbajtja e tyre

c) Aktorët e mundshëm

- Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit
- Institucioni që ndjek shpenzimet: NSHPP

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkoder

Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore (01.01.2024-07.11.2024)	652			652		
A.2	Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore (08.11.2024-31.12.2024)	113			113		

Shuma viti 2024		765			765		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore	765			765		
Shuma viti 2025		765			765		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve ujore	765			765		
Shuma viti 2026		765			765		
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2024, 2025, 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit Institucioni likujdues: Ndermarrja e shërbimeve dhe puneve publike					

Nr. 6	P06260.Q3.O1.A1 Shërbim I stafit të mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe dekorit	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore				
c) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<ul style="list-style-type: none"> Paga dhe shtesat mbi paga Shërbimet për shpenzime personeli do të bazohen tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave të VKM nr. 604 dt.14.09.2022 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM nr. 627 dt. 28.09.2022 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 234 datë 20.04.2022 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike"i ndryshuar, VKM nr. 621 dt. 28.09.2022 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 187 dt. 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit" të ndryshuar; Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". 						
ii. Synimi i projektit						
Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve. Analizë sipas ngarkesës, sipas funksioneve, ligjeve sektoriale për zbatim dhe akteve nënligjore për rolin e secilës drejtori dhe sektor.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Sigurimi i shpenzimeve 5. Paga, 6. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore						
b) Rezultatete pritshme						
<ul style="list-style-type: none"> Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë. Efektivitet të plotë të punës së punëtorëve të njësisë së ofrimit të shërbimeve 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
5. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 6. Institucioni që ndjek shpenzimet: NSHPP				Bashkia Shkoder		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2024		Total (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta Kapitale
A.1.	Paga dhe shtesat mbi paga	45,226	45,226			
A.2.	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	7,193		7,193		
A.3.	Dieta për punonjësit	49			49	
TOTALI 2024		52,468	45,226	7,193	49	
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2025		Total (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta Kapitale
A.1.	Paga dhe shtesat mbi paga	45,226	45,226			
A.2.	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	7,193		7,193		
A.3.	Dieta për punonjësit	49			49	
TOTALI 2025		52,468	45,226	7,193	49	
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2026		Total (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta Kapitale
A.1.	Paga dhe shtesat mbi paga	45,226	45,226			
A.2.	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	7,193		7,193		
A.3.	Dieta për punonjësit	49			49	
Totali 2026		52,468	45,226	7,193	49	
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2024, 2025, 2026			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likujdues: Ndermarrja e shërbimeve dhe puneve publike			

Nr. 7	P06260.Q3.O1.A2 Dekorimi i mjediseve publike	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260:Shërbimet Publike Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Shërbimin e dekorit Bashkia Shkodër e realizon me burimet e veta financiare, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore prej 5 punonjës të Drejtorisë së Ndriçimit Rrugor dhe Sinjalistikës. Me financimet në buxhetin e vitit 2023 është realizuar blerja e aksesorëve të rinj me të cilët dekorohen sheshet dhe akset kryesore të qytetit. Pjesa tjetër e dekorit realizohet me elementë të investuar në vite, të cilët janë gjëndje dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit të dekorit. Me këto elementë zbulorues dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Demokracia, Rus i madh, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, Zogu i Parë, Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhadol, Mehmet Pashë Plaku si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj.</p> <p>Realizimi i dekorit bëhet me punonjësit e Drejtorisë së Ndriçimit Rrugor dhe Sinjalistikës ku përveç specialistëve të dekorit që punojnë me kohë të plotë gjatë kësaj periudhe, për për realizimin e shërbimit angazhohen dhe specialistët e ndriçimit që punojnë me kohë të pjesshme për dekorin në rastet e festave.</p> <p>Krahas punës për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, realizohet shërbimi edhe në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë vitit, ku ndër më kryesoret janë aktivitetet tradicionale si 2 Prilli, Dita e Luleve, Dita e Karnevaleve, Festa e Pavarësisë, si dhe aktivitete të tjera që organizohen nga Bashkia.</p> <p><u>Problemet e paraqitura</u> Nevoja për shtrirjen e këtij shërbimi në rrugë e sheshe të tjera të qytetit si dhe nënjësitë administrative të Bashkisë. Amortizimi i elementëve të dekorit të blerë vite më parë. Nevoja për financime më të mëdha për realizimin e një dekori bashkëkohorë për të rritur cilësinë sipas pritshmërisë së qytetarëve.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<p>Viti 2024– 2025 – 2026 Përmirësimi cilësor i dekorit urban në qytet dhe njësitë administrative, sipas specifikave dhe traditave. Shtimi i numrit të aktiviteteve duke përfshirë edhe festat e ndryshme fetare me elementë dekorativ. Shtimi i sipërfaqeve të dekoruara me rastin e festave tradicionale.</p>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<p>I.Dekorimi i mjediseve publike Viti 2024 Janë parashikuar shpenzimet sipas preventivave për dekorin e mjediseve publike për festat e fundvitit, festat e tjera zyrtare si dhe aktivitetet e ndryshme të Bashkisë gjatë vitit.</p> <p>1. Blerje aksesorë dekori për festat:</p> <p>Blerja e aksesorëve shtesë, të cilët do të vendosen në sheshe e rrugë kryesore të Bashkisë. Pjesa tjetër e dekorit do të realizohet me aksesorë të blerë në vitet e kaluara, të cilët ruhen e mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Me këto aksesorë për festat e fundvitit do të realizohen dekorimi i akseseve kryesore të rrugëve të qytetit, dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Demokracia, Rus i madh, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, Zogu i Parë, Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhadol, Mehmet Pashë Plaku si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj.</p> <p>2. Blerje materiale të ndryshme për dekorin:</p> <p>Këtu përfshihen materialet e domosdoshme për riparimet e mundshme dhe montimin e aksesorëve të dekorit. Në zërat kryesorë të shpenzimeve përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kordon ndriçues dekorative (Ø 12 mm). • Tel përcjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm. • Lidhëse kabllorsh plastike. • Blerje flamuj për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore. <p>Viti 2025 Do të parashikohet blerja e aksesorëve për festat e fundvitit. Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjatë vitit</p> <p>Viti 2026 Do të parashikohet blerja e aksesorëve për festat e fundvitit. Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjatë vitit</p>		
b) Rezultatet që prisni		
<p>Viti 2024-2025-2026</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i dekorit më cilësor në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbanepër të rritur cilësinë sipas pritshmërisë së qytetarëve.; • Krijimi i dekorit më cilësor festiv me rastin e festave zyrtare dhe fetare si dhe aktivitete të tjera të që organizon bashkia. • Përmirësim dhe pasurim i dekorit në qytet dhe Njësi administrative 		

c) Aktorët e mundshëm Drejtoria e ndriçimit rrugor dhe sinjalistikës Administratorët e NjA		d) Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Shkodër Donatorët				
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Blerje aksesore dekorimi për festat e fundvitit.	4,200			4,200	
A.2	Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjate vitit.	800			800	
Shuma		5,000			5,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Blerje aksesore dekorimi për festat e fundvitit.	4,200			4,200	
A.2	Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjate vitit.	800			800	
Shuma		5,000			5,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Blerje aksesore dekorimi për festat e fundvitit.	4,200			4,200	
A.2	Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjate vitit.	800			800	
Shuma		5,000			5,000	
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2024, 2025, 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Ndrichimit Rrugor dhe Sinjalistikës Institucioni likujdues: Ndermarrja e sherbimeve dhe puneve publike				

Nr. 8	P06260.Q3.O1.A3 Mbeshtetje per infrastrukturën dhe shërbimet bazë të NSHPP	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore			
e) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
i. Situata					
Për administrimin e funksionimin e NSHPP kërkohet mbështetja dhe financimi për të gjitha shërbimet dhe mirëmbajtjen për krijimin e kushteve sa më të favorshme të punës. Për këtë kemi parashikuar ofrimin e shërbimeve në bazë të vlerësimit të nevojave, të planifikuara sipas zërave të aktiviteteve më poshtë:					
<ul style="list-style-type: none"> a) Nevoja për kancelari për pëmbushjen e detyrave dhe rritjen e performancës në punë. b) Materiale hidraulike Pompa uji, rubinetë, mishelatorë të ndryshëm, shkarkues banjo, tuba të ndryshëm fleksibël, vegla pune, çelës hidraulik, pincë hidraulike, etj). Gjithashtu Lyerjen e ambjenteve here pas here, shfaq nevojën për blerjen e artikullit bojë. c) Për të krijuar kushte sa më normale higjienike kemi vlerësuar nevojën e blerjes së materialeve që do mundësojnë mbajtjen në kushte higjienike normale është parashikuar blerja e materialeve të pastrimit dhe dezinfektantëve. d) Është bërë planifikimi për shërbimin e internetit. e) Në përmirësimin e infrastrukturës është parashikuar blerja e tryezave dhe karrige, rafte, etj. f) Gjithashtu në përmirësimin e kushteve të punës kërkohet blerjen e pajisjeve karriga, fotokopje, etj. g) Në zbatim të standarteve ligjore dhe kushteve teknike duhet të pajisen me fikse zjarri si dhe të rimbushen dhe të çertifkohen. 					
Parashikimi i shpenzimeve për shërbimet e nevojshme që ndërmarrja ka në funksionin e saj, zë një vend të rëndësishëm për mirëfunksionimin dhe kryerjen e detyrave të përditshme të saj. Kërkesat dhe nevojat që ka ndërmarrja për vazhdimësinë e punës renditen si më poshtë vijon:					
<ul style="list-style-type: none"> h) Furnizimi me ujë dhe likuidimi i faturave të ujit i cili është bërë korrekt dhe në kohë. i) Shërbimet postare mundësojnë dërgimin e dokumentacionit zyrtar, si domosdoshmëri e ushtrimit të funksioneve të saj. j) NSHPP ka detyrim ligjor për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet e tjera të pronave dhe inventarit të saj ekonomik. k) Sigurimet e ndërtesave reduktojnë barrën financiare dhe lehtësojnë vazhdimësinë e institucionit duke ulur kostot publike në rast të ndodhjes së fatkeqësive si zjarri apo katastrofa të tjera natyrore. 					
ii. Synimi i projektit					
<p>Përmirësimi i shërbimit.</p> <p>Përmirësimi i plotësisë të nevojave aktuale për rritjen e cilësisë së shërbimit</p> <p>Të krijohen kushte normale pune dhe në përmirësim të vazhdueshëm në funksion të rritjes së performancës së saj në ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit.</p> <p>Sigurimi i shërbimeve bazë (ujë, komunikim postar, etj) për pëmbushje të kushteve fizike normale gjatë kryerjes së funksioneve dhe detyrave të tyre të përditshme.</p> <p>Sigurimi i ndërtesës dhe inventarit të tyre ekonomik, për mbrojtjen e tyre në rast dëmtimesh fizike si p.sh: zjarri apo katastrofa të tjera natyrore.</p>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime; 2. Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit; 3. Marrja dhe vlerësimi i kërkesave për këto shërbime nga të gjitha drejtoritë. 4. Përgatitja e preventivave dhe dokumentacioneve përkatëse për të filluar procedurat për prokurim për secilin shërbim të nevojshëm. 5. Ndjekja dhe monitorimi i ofrimit të shërbimeve sipas specifikimeve të përcaktuara. 6. Furnizim me ujë 7. Shërbime postare 8. Shërbime telefoni celulare 9. Shërbime të printimit dhe publikimit në media 10. Vlerësimi i të gjitha pronave, ndërtesave dhe inventarit ekonomik të tyre nga subjekte apo individë të licencuar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme. 11. Përgatitja e preventivave dhe dokumentacionit për procedurën e prokurimit të shërbimit të sigurimit 12. Kryerja e shpenzimit për sigurimin e aseteve 13. Ndjekja dhe monitorimi i ofrimit të shërbimit sipas specifikimeve teknike të paracaktuara 14. Identifikimi i pajisjeve informatike që kanë nevojë për mirëmbajtje teknike, përgatitja e specifikimeve teknike të nevojshme dhe preventivimit brenda fondit limit të miratuar bazuar në testimin e tregut. 15. Identifikimi i nevojës për pajisje TIK, llojit dhe sasisë së tyre. 16. Përgatitja e specifikimeve teknike të nevojshme bazuar në rregulloren e specifikimeve teknike dhe preventivimi brenda fondit limit të miratuar bazuar në testimin e tregut. 					
b) Rezultatete pritshme					
Përmirësim i standartit të shërbimit; Furnizim me ujë, komunikim postar, publikime në media dhe printime, pagesë tarifash parkingu dhe sigurimin e shërbimeve të tjera të domosdoshme duke krijuar kushte fizike optimale në punë për administratën që ofron shërbimin për qytetarin, vizitorin, biznesin, etj.					
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Institucioni që ndjek shpenzimet: NSHPP 			Bashkia Shkoder		
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2024				Total (000 lekë)	Nga kjo:
				Paga	Sigurime
				Operative	Transferta
				Kapitale	
A.1	Blerje material kancelarie	1,000		1,000	

A.2	Blerje material hidraulike, bojë, etj.	50			50		
A.3	Blerje material për pastrim ambienti	300			300		
A.4	Blerje pajisje zyre	2,500					2,500
A.5	Vlerësimi i riskut						
A.6	Mirëmbajtje objekti	500			500		
A.7	Shërbim Interneti	200			200		
A.8	Blerje fikse zjarr	150			150		
A.9	Likuidimi i faturave të furnizim me ujë	150			150		
A.10	Shërbime postare	100			100		
A.11	Shërbime të printimit dhe publikimit në media	200			200		
A.12	Shërbime të tjera (larje automjete, tarifë parkingu, etj)	200			200		
A.13	Sigurimi i ndërtesës dhe inventari i tyre ekonomik	200			200		
A.14	Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	17,500					17,500
A.15	Mirëmbajtje pajisje informatike	0			0		
Shuma		23,050			3,050		20,000
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2025		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Blerje material kancelarie	1,100			1,100		
A.2	Blerje material hidraulike, bojë, etj.	55			55		
A.3	Blerje material për pastrim ambienti	330			330		
A.4	Blerje pajisje zyre	0					0
A.5	Mirëmbajtje objekti	550			550		
A.6	Shërbim Interneti	220			220		
A.7	Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarr	50			50		
A.8	Likuidimi i faturave të furnizim me ujë	170			170		
A.9	Shërbime postare	110			110		
A.10	Shërbime të printimit dhe publikimit në media	220			220		
A.11	Shërbime të tjera (larje automjete, tarifë parkingu, etj)	220			220		
A.12	Sigurimi i ndërtesës dhe inventari i tyre ekonomik	220			220		
A.13	Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	0			0		
A.14	Mirëmbajtje pajisje informatike	120			120		
Shuma		3,365			3,365		0
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2026		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
A.1	Blerje material kancelarie	1,210			1,210		
A.2	Blerje material hidraulike, bojë, etj.	60			60		
A.3	Blerje material për pastrim ambienti	360			360		
A.4	Blerje pajisje zyre	0			0		0
A.5	Mirëmbajtje objekti	600			600		
A.6	Shërbim Interneti	240			240		
A.7	Rimbushje dhe kolaudim fikse zjarr	55			55		
A.8	Likuidimi i faturave të furnizim me ujë	190			190		
A.9	Shërbime postare	120			120		
A.10	Shërbime të printimit dhe publikimit në media	240			240		
A.11	Shërbime të tjera (larje automjete, tarifë parkingu, etj)	240			240		

A.12	Sigurimi i ndërtesës dhe inventari i tyre ekonomik	240			240		
A.13	Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	0			0		
A.14	Mirëmbajtje pajisje informatike	130			130		
Shuma		3,685			3,685		0
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2024, 2025, 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likujdues: Ndermarrja e shërbimeve dhe puneve publike					

Nr. 9	P06260.Q3.O1.A4 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit per funksionimin e NSHPP	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore			
Përshkrimi i shkurtër i projektit:					
i. Situata					
Në funksion të NSHPP do të jenë 24 automjete. Pesë nga këto do t'i shërbejnë drejtorisë së ndriçimit rrugor. Mjetet në funksion kanë nevojë vazhdimisht për shërbime mirëmbajtje, furnizim me karburant, shërbimin e kontrollit teknik, pagesën e taksave dhe siguracioneve gjatë vitit.					
ii. Synimi i projektit					
Mjete transporti funksionale, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të punonjësve të NSHPP sipas nevojave që ato kanë.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
